

MONITORUESI I DREJTËSISË

1 korrik 2014 deri më 30 nëntor 2015




Organization for Security and Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo

Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë (OSBE) mbështet përpjekjet e sektorit të drejtësisë në Kosovë për ta rritur përputhshmërinë me të drejtën ndërkombëtare për gjykim të drejtë dhe standardet e sundimit të ligjit. Për të ndihmuar në këtë përpjekje, OSBE-ja monitoron procedurat gjyqësore dhe raporton rregullisht mbi to. Monitoruesi i Drejtësisë është publikim vjetor i gjetjeve të monitoruesve të OSBE-së në gjykatat e shkallës së parë në Kosovë (gjykatat themelore), të shpërndarë në shtatë rajonet vijuese: Ferizaj/Uroševac (FE/UR); Gjakovë/Đakovica (GJ/DJ); Gjilan/Gnjilane (GN); Mitrovicë/Mitrovica (MI); Pejë/Peć (PE); Prishtinë/Priština (PRN); Prizren (PZ). Monitoruesi i Drejtësisë synon që t'u sigurojë politikbërësve dhe akterëve të sektorit të drejtësisë treguesit e duhur, të cilët ndryshe nuk do të ishin në dispozicion, që do të ndihmonin në identifikimin e mangësive të përputhshmërisë në ndarjen e drejtësisë, si dhe për ta përcjellë progresin e arritur në përmirësimin e mangësive në fjalë.

MONITORIMI NGA OSBE

Departamenti i drejtësisë	Dëgjime	Rastet
Departamenti i përgjithshëm (raste penale)	1082	727
Departamenti i përgjithshëm (raste civile)	808	575
Departamenti për krime të rënda	1014	499
Departamenti për çështje administrative	223	104
Departamenti për të mitur	100	52
Gjithsej	3227	1957

GJYQARËT E MONITURUAR NË PËRQINDJE *




GJYKIMI BRENDA AFATIT TË ARSYESHËM

Efikasiteti i gjykatave

Në raportin e tij për statistikën e gjykatave për gjysmën e parë të vitit 2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka raportuar 396,603 lëndë të grumbulluara në Gjykatat Themelore. Efikasiteti i gjykatave (që përkufizohet si raporti mes lëndëve të përfunduara/lëndëve të pranura) ishte 104.51%. Pra, për 100 lëndë të reja, janë zgjidhur 105 lëndë. Në fund të vitit 2014, numri i lëndëve të grumbulluara ishte 403,022 dhe efikasiteti ishte 108.85%*


RESPEKTIMI I AFATEVE PROCEDURALE NË RASTET E MONITURUARA



ARSYET PËR SHTYRJE NË SEANCAT JOPRODUKTIVE

Seanca gjyqësore joproduktive* (877) 27%

Seanca gjyqësore produktive (2350) 73%




* Bazuar në listën e gjyqtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (e datës 18 shtator 2015), duke përfshirë gjyqtarët nga departamenti për çështje ekonomike dhe të kundërvajtjes, të cilët nuk janë monitoruar.

+ Këshilli Gjyqësor i Kosovës "Raport vjetor 2014"; "Raporti statistikor i gjashtëmujorit të (parë) 2015 mbi punën e gjykatave", e qasshme në <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>

‡ Në një "seancë gjyqësore joproduktive" nuk ndodh asgjë që ka vlerë ose substancë (nuk janë marrë prova, nuk janë dësgjuar apo nuk është vendosur në propozime, nuk janë shqyrtura çështje të menaxhimit të lëndëve, etj.)

QASJA NË DREJTËSI

PËRDORIMI I PËRFAQËSUESVE LIGJORË NË RASTET E MONITURUARA





Numri i avokatëve

Në Odën e Avokatëve të Kosovës janë 594 avokatë të regjistruar, ose 33 avokatë për 100,000 banorë. Në vitin 2014, Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë ka vlerësuar numrin e avokatëve në 47 juridiksione. Vetëm një juridiksion kishte më pak se 33 avokatë për 100,000 banorë.*

PËRDORIMI I PËRFAQËSUESVE LIGJORË NË RASTET E MONITURUARA

(SIPAS GJNISË DHE ETNISË)




MBROJTJA E PROVAVE


Regjistrimi i gjyqimeve penale

Neni 315(2) i Kodit të Procedurës Penale përcakton që "shqyrtimi gjyqësor regjistrohet në mënyrë audio ose video ose në mënyrë stenografike." OSBE ka monitoruar 699 seanca gjyqësore në raste penale. 48 prej këtyre seancave (7%) janë regjistruar në mënyrë audio dhe video. Transkripte stenografike ose fjalë për fjalë janë mbajtur në 144 (21%) seanca gjyqësore.

SHQETËSIMET E VËREJTURA GJATË SEANCËS SË SHQYRTIMIT TË PROVAVE (JANË PËRCJELLË 679 SEANCA TË SHQYRTIMIT TË PROVAVE)



VENDIMET E ARSYETUARA +



Të drejtat dhe liritë

OSBE-ja vlerësoi bazat e qarta për apelime në mbështetje të drejtave dhe lirive të garantuara me kushtetutë në 342 (18%) nga 1957 raste të monitoruara. OSBE-ja shprehu shqetësimin në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e 21 (10%) nga 207 gjyqtarëve të monitoruar.

* Komisioni Evropian për Efikasitetin e Sistemeve Gjyqësore, "Sistemet Evropiane të Drejtësisë - botimi i vitit 2014 (të dhënat e vitit 2012): efikasiteti dhe cilësia e drejtësisë" në dispozicion në http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/evaluation/2014/Rapport_2014_en.pdf

+ Gjatë periudhës raportuese janë vërejtur dhe analizuar 544 aktgjykime dhe 1361 vendime që nuk janë aktgjykime (më saktë, vendime që nuk janë referohen zgjidhjes së lëndës në fjalë)